



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.100/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Skender Lecaj nga Gjilani, të cilin e përfaqëson me autorizim S. Z. – B. J. “I. C.” në Gj., kundër të paditurve Rr. I nga Gj., dhe Z, A, nga Gj., për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të pohimit, duke vendosur sipas revizionit të paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1707/2017 datë 14.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.10. 2022, mori këtë,

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1707/2017 datë 14.04.2021.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1707/17 të dt.14.04.2021, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit S, L nga Gj., dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Cn.nr.462/2015 dt.23.03.2017, me të cilin, është hedh poshtë padia e paditësit, kundër të paditurve Rr. I dhe Z. A., nga Gj., lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, paditësi, ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, ” të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, i dt.23.03.2017 dhe ta refuzojë si të pabazuar aktvendimin e asaj gjykate e të vërtetohet se paditësi është pronar faktik e juridik, pasi pandërprerë e ka në posedim shfrytëzim e pushtet faktik paluajtshmërinë e lartë cekur, që në rastin konkret të zbatohen dispozitat ligjore të aplikueshme për këtë rast, gjegjësisht, lënda ti riprocedohet asaj gjykate në rivendosje meritore”.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 230 të LPK, shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve të revizionit ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, kundër të paditurve, ka paraqitur padi më dt.13.08.2015, për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë në bazë të pohimit. Gjykata e shkallës së parë, në shqyrtimin paraprak të padisë ka vërejtur se padia e dorëzuar në gjykatë nuk i përmbante të dhënat siç janë paraparë në nenin 99 dhe nenin 253 të LPK-së, përkatësisht, se kjo parashtrësë nuk ka qenë e kuptueshme sa i përket kërkesëpadisë e gjithashtu nuk i është përcaktuar adresa e saktë e të paditurve (por vetëm është theksuar se të njëjtit janë nga Gjilani), dhe për këtë arsye gjykata e ka pasur të pamundur që të veprojë, ndaj, me aktvendimin e dt.10.02.2017, padinë e paditësit e ka kthyer në plotësim, duke e obliguar të njëjtin që ta plotësojë padinë me përcaktimin e saktë se kush është i paditur në rastin konkret dhe adresën e saktë të njëjtëve, me paralajmërimin e pasojave procedurale. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit më datën 20.02.2017, ka dorëzuar në gjykatë një parashtrësë me të cilën ka pretenduar se e ka rregulluar - plotësuar padinë në bazë të aktvendimit të lartë cekur, por, nga përmbajtja e parashtrësës del se ai nuk ka plotësuar asgjë, i njëjti ka shpjeguar se çfarë ka bërë paditësi në ngastrën kontestuese, (flet për meritat, bazueshmërinë, etj) d.m.th. nga kjo parashtrësë shihet se i njëjti nuk ka potencuar se kush janë të paditurit dhe adresën e saktë të tyre, siç është kërkuar me aktvendimin C.nr.462/15 dt.10.02.2017, pra, parashtrësja është kthyer pa u korrigjuar gjegjësisht, pa u plotësuar.

Nisur nga gjendja e këtyllë faktike, gjykata e shkallës së parë, duke iu referuar dispozitës së nenit 102.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, në tërësi e ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, e ka refuzuar ankesën e palës paditëse dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, kur nga arsyet e sipër theksuara, kanë vendosur si në dispozitivin e aktvendimeve të tyre, përkatësisht , për hedhjen

poshtë të padisë së paditësit. Aktvendimet e tyre nuk janë të përfshira me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndaj, pretendimet e revizionit për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk mund ta vënë në dyshim aktvendimin e goditur dhe si të tilla u konsideruan të pathemelta, ndërsa, aktvendimi i gjykatës së instancës më të ulët është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu sepse, me dispozitën e nenit 102.3 të LPK-së, shprehimisht përcaktohet se “ Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë “, sikundër edhe ka vepruar gjykata e instancës më të ulët. Kështu, nga fakti sepse parashtresa i është kthyer gjykatës së shkallës së parë pa u korrigjuar dhe pa u plotësuar nga pala paditëse, e cila, d.m.th. sërish nuk plotëson saktë adresën e palës së paditur, pra, pa precizuar saktë adresën e të paditurit Z, A, nga Gj, etj,(siç shprehet në të), si dhe pa shpjegimin a saktësimin se kush janë ” të tjerët ”.

Nga këtu dhe nga arsyet e sipër përmendura, kjo Gjykatë, vlerëson se nuk qëndrojnë thëniet e revizionit për shkeljet e pretenduara dhe si të tilla, ato janë të paqëndrueshme dhe të pa themelta, ndërsa, në rastin konkret, gjykatat e instancës më të ulët, kanë marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 230 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.100/2022 datë 25.10.2022

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha

